

RAPORT FINAL I AUDITIMIT

Objekti i auditimit: Auditim i sistemit të kontrollit përputhshmërisë dhe financiar.

Njësia e audituar: Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Njësia audituese: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e MFE-së

Përmbledhje ekzekutive

Në zbatim të Ligjit nr. 114, datë 06.11.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe planit të auditimit nr. 6929/1, datë 20.04.2018, në Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, (AKÇESK), është kryer një mision auditimi “Për auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm përputhshmërisë dhe financiar”.

Në përfundim të misionit ka rezultuar:

- Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik deri në momentin e auditimit nuk ka të miratuar rregulloren e brëndëshme.
- Numri i punonjësve nuk është plotësuar sipas strukturës së miratuar, nga 17 punonjës sipas organikës aktualisht janë 12 punonjës.
- Kriteret e përzgjedhjes së punonjësve, procedurat e emërimit si dhe përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi duhet të përcaktohen në rregulloren e brendshme sipas kërësive të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe strukturën e miratuar.
- Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik nuk ka bërë identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që kanë efekt të dëmshëm në përmbushjen e objektivave të saj.
- Ende nuk ka një sistem të dedikuar për verifikimin e vlefshmërisë së produkteve të gjeneruara nga shërbimet e besuara të huaja, të njohura nëpërmjet ndryshimeve ligjore sipas ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, duke mundur aksesin publik për kontrollin e vlefshmërisë së tyre nëpërmjet listave të besuara të vendeve anëtare të BE-së dhe protokollin on-line të statusit të certifikatave dhe listave të revokimit të certifikatave. Ky sistem është konceptuar të ngrihet me fondet IPA. Autoriteti është në pritje të miratimit të projektit.
- Kontrolli dhe implementi i të gjitha standardeve teknike të zbatuara nga institucionet e shoqërisë së informacionit, apo infrastruktura e informacionit edhe në sektorin privat janë ende të përpilizuara, për shkak të procesit ende të papërfunduar të hartimit të metodologjisë për funksionimin e CSIRT-ve. Pritet që brenda muajit korrik të miratohet metodologjia në konsultim me CSIRT-et sektoriale dhe tju përcillet atyre së bashku me masat e sigurisë për implementim. Pas kësaj faze autoriteti mund të kryejë funksionet e veta audituese.
- Rekrutimi i punonjësve është kryer konform ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Procedurat e Prokurimit janë kryer konformë Udhëzimit të Agjencisë Prokurimit Publike, e nr.3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar.
- Llogaritjet dhe ndalesat për sigurime shoqërore dhe tatim page, janë kryer konformë dispozitave ligjore në fuqi.

- Për vitin 2017, realizimi i planit të buxhetit në total është në masën 11%. Shpenzimet korente janë realizuar në masën 55% dhe fondet për investime në masën 1%.
- Planifikimi dhe miratimi i fondeve për investime është bërë me rezevë pasi autoriteti është ngritur si institucion i ri në Maj të vitit 2017.
- Për vitin 2018 janë planifikuar 18 milion lekë për investime nga 64 milion që ishin planifikuar për vitin parardhës.
- Mosrealizimi i fondeve për investime ka çuar në mosrealizimin e objektivave të këtij autoritetit. Theksojmë se ndikim në këtë drejtim ka patur edhe mosplotësimi i organikës me personelin e kërkuar si dhe procesi i ngritjes dhe konsolidimit të autoritetit si institucion i ngritur rishtazi.

I. Hyrje

Në këtë Raport janë paraqitur gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të auditimit pas përfundimit të misionit auditues të kryer në Autoritetit Kombëtare të Çertifikimit Elektronik dhe të Sigurisë Kibernetike. Fushat e auditimit sipas parashikimit në Planin e auditimit janë; auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm; auditimi i pajtueshmërisë dhe auditimi financiar. Veprimtaria e këtij Autoriteti, bazohet në ligjin 9880, datë 25.02.2008 “Për Nënshkrimin Elektronik”, Ligjin nr. 107/2015 “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimrt e Besuara” si dhe në VKM nr. 141, datë 22.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtare të Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike” si dhe akte të tjera nënligjore në zbatim të ligjit. Auditimi është zhvilluar në përputhje me legjislacionin, Manualët e procedurave si dhe standartet ndërkombëtare të pranura në fushën e auditimit të brendshëm të sektorit publik.

Objekti i misionit të auditimit: “Të arrijë të japë siguri të arsyeshme për Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, nëse veprimtaria e Autoritetit Kombëtare të Çertifikimit Elektronik dhe të Sigurisë Kibernetike funksionon mbi një sistem të kontrollit të brendshëm efektiv, nëse kjo veprimtari është zhvilluar në pajtim me rregullat e jashtme (ligje, akte nënligjore) dhe ato të brendshme (udhëzime, urdhëra manuale, rregullore etj).

Auditimi u përqëndrua në vlerësimin e zbatimit të rregullave të brendshme dhe të jashtme që rregullojnë veprimtarinë e autoritetit, funksionimi i strukturave të drejtimit, menaxhimin e fondeve në mbështetje të investimeve, menaxhimin burimeve njerëzore dhe pagave, në zbatimin e rregullave për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit për vitin 2017 dhe 2018.

II. Termat e Auditimit

Termat e auditimit janë parashikuar në Planin e auditimit nr.8679/1, datë 18.05.2018, si mision i planifikuar në planin vjetor të Drejtorisë së Auditimit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 134, datë 15.11.2017 “Për miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor 2018 të Drejtorisë së Auditimit”.

Auditimit i veprimtarisë së Autoritetit Kombëtare të Çertifikimit Elektronik dhe të Sigurisë Kibernetike u krye për periudhën 01.01.2017 deri 30.04.2018.

Auditimi u realizua në terren gjatë periudhës 21.05.2015 deri 15.06.2018. Për realizimin e misionit është autorizuar grupi i punës i përbërë nga Latif Çela përgjegjës dhe Flori Alla auditues.

Në zbatim të Manualit të AB, Autoriteti Kombëtar i Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike është njoftuar zyrtarisht për fillimin e këtij misioni me shkresën nr.8679/1, datë 04.05.2018.

III. Metodat e Përdorura

Grupi i auditimit ka përdorur metoda dhe teknika auditimi në varësi të fushës së audituar. Është përdorur metoda e intervistimit, e studimit të raporteve, krahasimit dhe modelimit statistikor etj. Gjithashtu janë përdorur teknikat të përzgjedhjes dhe ekzaminimit të transaksioneve në grup dhe pjesorë.

IV. Gjetjet e Auditimit

Në vijim janë renditur gjetjet e auditimit në fushën e veprimtarisë së Autoritetit Kombëtare të Çertifikimit Elektronik dhe të Sigurisë Kibernetike për periudhën e audituar.

I. Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.

1. Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm për pesë komponentët (mjedisi i kontrollit, aktivitetet e kontrollit, vlerësimi i riskut, komunikimi dhe monitorimi).

o Mjedisi i Kontrollit

Mjedisi i kontrollit të brendshëm në Autoritetin Kombëtar të Çertifikimit Elektronik dhe të Sigurisë Kibernetike përfshin procesin e kontrollit mbi menaxhimin e veprimtarisë së autoritetit në fushën e zbatimit të rregullave për mbikqyrjen dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi në fushën e nënshkrimit elektronik, identifikimin elektronik e shërbimet e besuara, si dhe legjislacionit në fuqi në fushën e sigurisë kibernetike, menaxhimin e burimeve njerëzore, në zbatimin e rregullave për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të autoritetit.

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, u krijua si rezultat i bashkimit të dy institucioneve “Autoriteti Kombëtar i Çertifikimit Elektronik (AKCE)” dhe “Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT)” sipas VKM nr. 141, datë 22.2.2017 për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar Për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

Autoriteti Kombëtar i Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike ushtron veprimtarinë e tijë bazuar në ligjin 9880, datë 25.02.2008 “Për Nënshkrimin Elektronik”, Ligjin nr. 107/2015 “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara” si dhe të VKM-së nr. 141, datë 22.02.2017,

“Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike” si dhe akte të tjera nënligjorë në zbatim të ligjit.

Nga auditimi u konstatua se: në zbatim të legjislacionit të mësipërm me urdhërin Nr. 47, datë 12.04.2017, të Këshillit të Ministrave është miratuar struktura dhe organika e Autoritetit Kombëtar të Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike.

Autoriteti për periudhën objekt auditimi ka funksionuar sipas strukturës së miratuar me vendimin e mësipërm me 17 punonjës në organikë prej të cilëve 1 drejtor i përgjithshëm, 2 drejtor drejtorie, 1 përgjegjës sektori dhe 13, punonjës me statusin e nëpunësit civil. Në mënyrë të detajuar organizimi dhe funksionimi i strukturës organizative është trajtuar në pikën e raportit mbi zbatimin e procedurave në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe pagave

Struktura është e pa plotësuar për disa pozicione pune. Numri i punonjësve sipas planit të buxhetit të miratuar për vitin 2017 dhe 2018 është 17 punonjës. Aktualisht struktura është plotësuar me 12 punonjës.

Për periudhën e audituar punonjësit e këtij autoriteti kanë vepruar dhe kanë realizuar detyrat e tyre bazuar në legjislacionin e sipërpërmendur. Autoriteti nuk ka rregullore të miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i KM për funksionimin e brendshëm. Për periudhën e audituar punonjësit e kësaj drejtorie kanë vepruar dhe kanë realizuar detyrat e tyre bazuar në legjislacionin në fuqi për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike. Nga drejtori i drejtorisë janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për secilin punonjës të drejtorisë.

Gjithashtu janë përcaktuar linjat e raportimit sipas shkallës hierarkike, nga specialisti te përgjegjësi i sektorit, dhe ky i fundit te drejtori i drejtorisë.

Nga auditimi u konstatua se punonjësit e kësaj drejtorie kanë përvojë pune dhe janë të aftë profesionalisht për të përmbushur detyrat e ngarkuara.

Gjithashtu në rregullore janë përcaktuar linjat e raportimit sipas shkallës hierarkike, nga specialisti, Përgjegjësi i sektorit drejtori i drejtorisë dhe te drejtori ekzekutiv.

○ **Aktivitetet e kontrollit**

Veprimtaria kryesore e autoritetit është: Mbikqyrja dhe zbatimi i rregullave për zbatimin e kërkesave të legjislacionit në fuqi në fushën e nënshkrimit elektronik, identifikimin elektronik e shërbimet e besuara, si dhe legjislacionit në fushën e sigurisë kibernetike.

Për rregullimin e veprimtarisë së brendshme në përputhje me ligjet dhe strukturën organizative autoriteti nuk ka hartuar rregulloren e brendshme të funksionimit të administratës së saj. Në këtë rregullore duhet të jenë të përcaktuara, parimet e organizimit dhe funksionet e administratës, parimet e administrimit të burimeve njerëzore, marrëdhëniet e punës, të drejtat dhe detyrat e strukturave të ngritura dhe të miratuara nga legjislacioni i mësipërm.

Në këtë rregullore duhet të përcaktohen edhe detyrat sipas funksioneve, emërtesave të hierarkisë dhe nomenklaturës.

Nga auditimi u konstatua se, kriteret e përzgjedhjes, procedurat e emërimit dhe largimit nga puna janë sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Sipas strukturës Autoriteti është organizuar me 2 drejtori dhe 1 sektorë. Kontrolli i aktivitetit realizohet nga Drejtori i Përgjithshëm, nëpërmjet sistemeve të vendosura që nga ndarja e detyrave funksionale

të çdo punonjësi, të raportimeve ditore për punën që kryhet dhe të sistemit të raportimeve periodike mujore e vjetore nga drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorit. Lidhur me ndarjen e punëve dhe papajtueshmërinë midis funksioneve, nga grupi i auditimit nuk u konstatuan raste të pa pajtueshmërisë midis funksioneve.

Rekomandim nr. 1 Autoriteti Kombëtarë i Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike të miratojë rregulloren e brendshme dhe të përshtasë atë në përputhje me kërkesat e ligjit “ Për nëpunësin civil” dhe strukturën organizative të miratuar. (Rëndësia i/e mesme)

Rekomandim nr. 2. Drejtori Përgjithshëm të kërkojë plotësimin e vendeve vakant për të garantuar realizimin e objektivave të përcaktuara nga autoriteti. (Rëndësia i/e mesme).

○ **Menaxhimi i Riskut.**

Nga auditimi u konstatua se autoriteti nuk ka bërë identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që kanë efekt të dëmshëm në përmbushjen e objektivave të saj. Gjithashtu Autoriteti nuk ka regjistër Risku.

Lidhur me këtë fakt rekomandojmë:

Rekomandim nr. 3. Autoriteti Kombëtarë i Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike të evidentojë risqet dhe të hartojë regjistrin e saj të riskut. (Rëndësia e mesme).

○ **Komunikimi dhe Raportimi**

Mënyra e komunikimit dhe raportimit të Drejtori i Përgjithshëm është formalizuar sipas draft rregullore së brendshme. Drejtori ekzekutiv informohet rregullisht nëpërmjet komunikimit gojor, memove, raporteve të monitorimit dhe analizës. Ky komunikim ka qenë i drejtpërdrejtë, me postë elektronike dhe zyrtarisht në formë shkresore për informacionet hyrëse dhe dalëse. Sistemi i raportimit është i rregulluar për raportet e drejtim/administrimit, për mënyrën e administrimit të dokumentacionit, transaksioneve dhe të protokoll-arkivit.

○ **Monitorimi**

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të agjencisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se, aktiviteti i kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin është ngritur kjo agjenci. Drejtoria e autoritetit ka një sistem monitorimi të pasqyruar në ndarjen e detyrave midis drejtorive, sektorëve dhe çdo punonjësi të agjencisë. Mbikqyrja e punës së gjithësecilit bëhet sipas shkallës hierarkike.

II. Auditimi i Pajtueshmërisë

1. Respektimi i rregullave të brendshme dhe të jashtme që rregullojnë veprimtarinë e Institucionit, Funksionimi i strukturave të drejtimit dhe administrimit.

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, ushtron veprimtarinë e tij, bazuar në;

- ✦ Ligjin, nr.9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar.
- ✦ Ligjin, nr.107/2015, datë 01.10.2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”.
- ✦ Ligjin, nr. 2/2017, datë 26.01.2017 “Për sigurinë kibernetike”.
- ✦ Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar për certifikimin elektronik dhe sigurinë kibernetike”.
- ✦ Urdhërin e Kryeministrit nr.47, datë 12.04.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së autoritetit kombëtar për certifikimin elektronik dhe sigurinë kibernetike”.

Struktura e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin dhe Sigurinë Kibernetike, është si më poshtë:

- ❖ Drejtor i Përgjithshëm.
- ❖ Drejtoria e Certifikimit Elektronik.
 - Sektori i Akreditimit.
 - Sektori i Kontrollit.
- ❖ Drejtoria e Sigurisë Kibernetike.
 - Sektori i Monitorimit & Reagimit ndaj Emergjencave.
 - Sektori i Standartizimit.
- ❖ Sektori i Financës & Shërbimeve Mbështetëse.

Objekti i Veprimtarisë i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike është: ***mbikqyerja dhe zbatimi i legjislacionit në fuqi në fushën e nënshkrimit elektronik, identifikimin elektronik e shërbimeve të besuara, si dhe legjislacionit në fuqi në fushën e sigurisë kibernetike.***

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit Nr.9880/2008 “Për Nënshkrimin Elektronik”, Ligjit Nr.107/2015, “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara” si dhe Ligji Nr. 2/2017, “Për Sigurinë Kibernetike” dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

Misioni i Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Garanton sigurinë për shërbimet e besuara, në veçanti për garantimin e besueshmërisë dhe sigurisë në transaksionet elektronike ndërmjet qytetarëve, biznesit dhe autoriteteve publike, duke rritur efektivitetin e shërbimeve publike e private dhe tregtisë elektronike si dhe përcakton standardet minimale teknike për sigurinë e të dhënave dhe rrjeteve/sistemeve kompjuterike të shoqërisë së informacionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare në këtë fushë, me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt elektronik.

Në zbatim të VKM Nr.141, datë 26.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e AKCESK”, sipas detyrave funksionale, që prej muajit Majit të vitit 2017 e në vazhdim, në të cilën ka filluar të ushtrrojë veprimtarinë e tij autoriteti, ka përmushur këto detyra:

Në fushën e certifikimit elektronik:

- ✦ Është plotësuar i gjithë kuadri ligjor që normon fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara (Udhëzime për ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar OKSHB).
- ✦ Janë krijuar dhe mirëmbahen listat e besuara në nivel kombëtar, sipas përcaktimeve të standardeve të Bashkimit Europian. Informacioni është i aksesueshëm në webfaqen e institucionit.

➤ Janë kryer inspektimet periodike me qëllim monitorimin e procesit të lëshimit të certifikatave të kualifikuara nga OKSHB (ALEAT sh.p.k i cili lëshon certifikata të kualifikuara që gjenerojnë identifikim dhe nënshkrim elektronik për qytetarët të inkorporuar në kartën e identitetit ose letërnjoftimin zyrtar. Gjithsej janë të lëshuara që prej datë 1 janar 2014 rreth 800.000 certifikata të kualifikuara të cilat shërbejnë për të kryer transaksione të sigurta të cilat konsistojnë në marrjen e shërbimeve publike apo transaksime të ndryshme bankare. AKSH-i lëshon certifikata të kualifikuara, të cilat gjenerojnë identifikim elektronik, nënshkrim elektronik dhe vula elektronike për administratën publike dhe biznesin. Gjithsej janë lëshuar rreth 9000 certifikata të kualifikuara).

➤ Janë kryer inspektime në 72 zyra rajonale në të cilat ALEAT kryen një pjesë të shërbimit që ofron, i cili konsiston në identifikimin e saktë të aplikuesve, ndërveprimin me platformën qëndrore dhe dorëzimin e mjetit mbajtes të certifikatës tek zotëruesi.

➤ Në kuadër të transformimit të shërbimeve publike në formatin elektronik si rregullator i fushës AKCESK, ka hartuar Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.495, datë 13.09.2017 *“Për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve publike elektronike”*, nëpërmjet të cilës qytetarët dhe biznesi, përfitojnë dhjetra shërbime elektronike në kohë reale, të sigurta dhe pa kosto.

➤ Ka realizuar fushatë ndërgjegjësuere/promovuese për përdorimin e identifikimit dhe nënshkrimit elektronik nga qytetarët tek biznesi për të përfutur shërbime publike.

➤ Ka realizuar ndërlidhjen e faqes zyrtare të internetit të Autoritetit me platformën e ALEAT për tju ardhur në ndihmë të gjithë qytetarëve për të nënshkruar dokumenta të ndryshëm elektronik lehtësisht dhe falas.

➤ Janë hartuar rregullore që përcaktojnë skemat e identifikimit elektronik, vulave elektronike, transferimin e detyrave të shërbimeve të besuara, shërbimin e transmetimit elektronik, autentifikimin e faqeve të internetit.

➤ Ka krijuar dhe përditësuar regjistrin elektronik për procedurat e kontrollit, si dhe ka krijuar dhe publikuar regjistrin për Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar (OKSHB).

Rekomandim 4. Të krijohet një sistem i dedikuar për verifikimin e vlefshmërisë së produkteve të gjeneruara nga shërbimet e besuara të huaja, të njohura nëpërmjet ndryshimeve ligjore duke mundësuar aksesin publik për kontrollin e vlefshmërisë së tyre nëpërmjet listave të besuara të vendeve anëtare të BE-së dhe protokollin on-line të statusit të certifikatave dhe listave të revokimit të certifikatave.(Rëndësia e lartë).

2.Zbatimi i procedurave në fushën e nënshkrimit elektronik, identifikimi elektronik të shërbimeve të besuara dhe atë të sigurisë kibernetike.

Në fushën e sigurisë kibernetike

➤ Bashkërendon punën me institucionet publike dhe private, të cilat disponojnë sisteme kritike e të rëndësishme të informacionit, dhe përgjigjet me kundërmasa ndaj kërcënimeve/sulmeve kibernetike.

➤ Është hartuar metodologjia dhe bllokskema për identifikimin e infrastrukturave kritike dhe i është komunikuar të gjitha institucioneve publike dhe sektorit bankar që aministrojnë infrastrukturën e informacionit. Pas një periudhe 6-mujore punë mbështetese, koordinuese dhe konsultative me të gjitha keto institucione, autoriteti ka hartuar draft VKM-në, *“Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit”*, e cila është miratuar me nr.222, datë 26.04.2018.

➤ Në zbatim të VKM nr.222, datë 26.04.2018, Autoriteti ka koordinuar punën me të gjitha pikat e kontaktit të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme për të hartuar metodologjinë për organizimin dhe funksionimin e CSIRT-ve (kombëtar dhe atyre sektorial).

➤ Në zbatim të ligjit nr.2/2017, “Për sigurinë kibernetike” si dhe VKM-së së sipërcituar Autoriteti ka miratuar rregulloren për masat e sigurisë të cilat do të implementohen nga të gjithë operatorët që administrojnë infrastruktura kritike dhe të rëndësishme të informacionit, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë në vend. Gjithashtu rregullorja për masat e sigurisë është publikuar në webfaqen e Autoritetit.

➤ Në kuadër të bashkëpunimit me UNICEF dhe Agjencinë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, janë organizuar fushata ndërgjegjëse në shkollat 9-vjeçare të kryeqytetit, me fokus përdorimin e internetit të sigurt nga fëmijët, si një nga prioritetet e përbashkëta me këto institucione.

➤ Ka krijuar dhe përditësuar regjistrin elektronik të ngjarjeve/incidenteve kibernetike dhe regjistrin e pikave të kontaktit kombëtare/ndërkombëtare.

Të përgjithshme.

Autoriteti Kombëtarë i Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike vepron gjithashtu si institucion koordinues për institucionet publike dhe organizmat ndërkombëtare (NATO, OSCE, etj) për çështjet e sigurisë, si dhe është anëtar me të drejta të plota në FESA (Forum of European Supervisory Authorities), ku raportohet për çështjet e çertifikimit elektronik.

Përfundimishtë theksojmë.

➤ Ende nuk ka një sistem të dedikuar për verifikimin e vlefshmërisë së produkteve të gjeneruara nga shërbimet e besuara të huaja, të njohura nëpërmjet ndryshimeve ligjore sipas ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, duke mundësuar aksesin publik për kontrollin e vlefshmërisë së tyre nëpërmjet listave të besuara të vendeve anëtare të BE-së dhe protokollin on-line të statusit të çertifikatave dhe listave të revokimit të çertifikatave. Ky sistem është konceptuar të ngrihet me fondet IPA. Autoriteti është në pritje të miratimit të projektit.

➤ Në lidhje me përgatitjen e strategjisë kombëtare në fushën e sigurisë elektronike, në përputhje me parashikimet sipas legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik, për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara si dhe për sigurinë kibernetike, është hartuar një draft urdhër për Kryeministrin për ngritjen e grupit të punës ndërinstitucional, që prej nëntorit të vitit 2017. Për koordinimin e punës me të gjithë sektorët me qëllim përfitimin e një produkti sa më cilësor dhe efikas, duke qenë se Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e cila administron të gjitha sistemet e informacionit në nivel qeverie, është në fazën e hartimit të politikave për çështjet e sigurisë, puna për hartimin e strategjisë është shtyrë pas përfundimit të kësaj faze.

➤ Kontrolli dhe implementi i të gjitha standardeve teknike të zbatuara nga institucionet e shoqërisë së informacionit, apo infrastruktura e informacionit edhe në sektorin privat janë ende të parealizuara, për shkak të procesit ende të papërfunduar të hartimit të metodologjisë për funksionimin e CSIRT-ve. Pritet që brenda muajit korrik të miratohet metodologjia në konsultim me CSIRT-et sektoriale dhe tju përcillet atyre së bashku me masat e sigurisë për implementim. Pas kësaj faze autoriteti mund të kryejë funksionet e veta audituese.

➤ Sistemi/portali unik on-line, për publikimin e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme, aktualisht është jashtë funksionit për shkak të mosrealizimit të mirëmbajtjes së tij. Autoriteti i është drejtuar AKSHI-it si organi kompetent që administron të gjitha sistemet të

informacionit në nivel qeverie, me shkresë zyrtare që në muajin mars 2018, për realizimin e mirëmbajtjes dhe një shtese moduli për të rritur funksionalitetin e këtij sistemi/portali. AKSH-i është duke organizuar punën për zhvillimin e prokurimit publik me këtë objekt në bashkëpunim me autoritetin.

Rekomandim 5. Të kryehet kontrolli dhe implementi i të gjitha standardeve teknike të zbatuara nga institucionet e shoqërisë së informacionit, apo infrastruktura e informacionit edhe në sektorin privat që janë ende të parealizuara, për shkak të procesit ende të papërfunduar të hartimit të metodologjisë për funksionimin e CSIRT-ve. (Rendesia e lartë).

3.Zbatimi i procedurave të planifikimit dhe kryerjes së prokurimeve publike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Administrimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit.

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2017 deri më 30.04.2018, pranë Autoritetit Kontraktor të Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike, Tiranë janë zhvilluar procedura prokurimi “Blerje me vlera të vogla”.

➤ Janë hartuar Rregjistrat e parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2017 e 2018, drejtuar Agjencisë Prokurimit Publik.

➤ Janë hartuar dhe dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik Rregjistri i realizimit të Prokurimeve Publike, për vitin 2017 e 4-mujorin 2018.

➤ Rregjistrat e Prokurimeve Publike, janë miratuar nga ana e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për vitin 2017, e 2018.

➤ Në fillim të çdo viti Titullari i Autoritetit Kontraktor, ka ngritur Komisionin e prokurimit me vlerë të vogël. sipas pikës 2, të Udhëzimit të Agjencisë Prokurimit Publike, nr.3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”.

REALIZIMI I PROCEDURAVE PROKURIMEVE NE MENYRE ELEKTRONIKE

VITI 2017

Nr	Emertimi	Fondi Limit	Vlefte Kontrates	Vlefte me TVSH	Operatori Fitues
1	Shërbime Printimi dhe Publikimi	170.000	129.600	155.520	Sakuli
2	Shpenzime Udhëtimi.	39.600	37.800	37.800	Adenis Pashaj
3	Shpenzime Udhëtimi.	105.163	88.500	88.500	Adenis Pashaj
4	Pritje përcjellje.	157.200	134.640	161.568	Helios Gastronomi
5	Shpenzime Udhëtimi.	156.747	149.500	149.500	Ermal Osmënaj
6	Shpenzime Udhëtimi.	71.100	67.000	67.000	Ermal Osmënaj

7	Shpenzime Udhëtimi.	93.166	89.600	89.600	Adenis Pashaj
8	Ripar.paisje Elektrike	16.233	16.120	19.344	Eridion shpk
9	Blerje Kancelari.	237.143	155.700	186.840	Magrip Bana
	Shuma	1.046.352	868.460	955.672	

Për vitin 2017, janë zhvilluar **9 procedura prokurimi** “Blerje me vlera te vogla”, me fond limit **1.046.352 lekë pa TVSH**, vleftë kontrate **868.460 lekë pa TVSH**, dhe **955.672 lekë me TVSH**.

REALIZIMI I PROCEDURAVE PROKURIMEVE NE MENYRE ELEKTRONIKE

4-Mujori 2018

Nr	Emertimi	Fondi Limit	Vlefta Kontrates	Vlefta me TVSH	Operatori Fitues
1	Shërbime Printimi dhe Publikimi	47.600	35.000	42.000	Univerz Reklama
2	Riparim Printeri	7.000	6.500	7.800	Elisa Dyrmishi
3	Sherb.e materiale pastrimi	770.468	728.500	874.200	Pastrime Silvio
4	Shpenzime Udhëtimi.	63.813	63.813	63.813	Ermal Osmënaj
5	Shp.Mirmb.Objekti	504.270	327.600	393.120	Drini A
	Shuma	1.393.151	1.161.413	1.380.933	

Për 4-mujorin 2018, janë zhvilluar **5 procedura prokurimi** “Blerje me vlera te vogla”, me fond limit **1.393.151 lekë pa TVSH**, vleftë kontrate **1.161.413 lekë pa TVSH**, dhe **1.380.933 lekë me TVSH**.

Përfundimishtë arrijmë në konkluzionin se:

- Llogaritja e fondit limit, është kryer konform pikës 4, paragrafi 3, të Udhëzimit të Agjencisë Prokurimit Publike, e nr.3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar.
 - Procedurat e Prokurimit është kryer konformë Udhëzimit të Agjencisë Prokurimit Publike, e nr.3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar.
- 4.Zbatimi i procedurave në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe pagave.**

Struktura organizative e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Tiranë dhe organika e saj është miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr.47, datë 12.04.2017 *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së autoritetit kombëtar për certifikimin elektronik dhe sigurinë kibernetike”*. Numri i punonjësve të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin dhe Sigurinë Kibernetike, **është miratuar gjithsej 17 vetë.**

Ky institucion sipas organigramës (skemës) së miratuar (Për periudhën objekt auditimi), është i organizuar mbi bazën e **2 Drejtorive dhe 5 Sektorëve.**

Sipas këtij urdhëri Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Tiranë, ka në strukturë **2 Drejtori dhe 5 Sektorë dhe Drejtori i Përgjithshëm.**

Këto Drejtori e Sektorë sipas organigramës (skemës) së miratuar janë;

- Drejtori i Përgjithshëm, **1 vetë.**
- Drejtorja e Certifikimit Elektronik, **7 vetë.**
- Drejtorja e Sigurisë Kibernetike **6 vetë.**
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve mbështetëse, **3 vetë.**

Nga krahasimi i numrit të miratuar, me numrin e punonjësve faktikë për periudhën objekt auditimi, rezulton se: Numri faktik i punonjësve është **12 vetë, pra me pakë për 5 vetë.**

Pra struktura organike e miratuar rezulton e pa plotësuar për 5 veta, nga të cilët, Drejtor i Sigurisë Kibernetike (1), Specialistë në Sektorin e Monitorimeve dhe Reagimit ndaj Emergjencave (1), Specialistë në Sektorin e Standartizimit (1), Specialistë në Sektorin e Kontrollit (1), dhe Specialistë në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (1).

Mbi rekrutimin dhe emërimin në detyrë të disa nëpunësve.

Marrëdhëniet e punës të nëpunësve/punonjësve të Autoritet Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, janë të rregulluara nga:

✓ Ligji nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*; i ndryshuar.

Mbështetur në detyrimin e përcaktuar në pikën 3, të Kreut III të VKM nr. 116, datë 05.03.2014 *“Për Statusin e Nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit Civil”*, Autoriteti Kombëtar i Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike, ka dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike, listën e plotë të nëpunësve së bashku me dosjen përkatëse.

Në mbështetje të nenit 67, të ligjit 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”*, i ndryshuar, Kreut III pika 1/b dhe 2 të VKM nr. 116, datë 05.03.2014 *“Për Statusin e Nëpunësve dhe Punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit Civil”*, Departamenti i Administratës Publike, pas verifikimit të dokumentave në përmbajtjen e dosjes së çdo punonjësi me kërkesat ligjore në fuqi, ka përcjellë pranë Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike, *“Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit”*.

Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve dhe realizimi i fondit të pagave.

Sipas VKM nr.187, datë 08.03.2017, *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendëskryeministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës.....Institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës.....”*, pika 1/2 dhe 8/3, Lidhja nr.5/3, bashkëlidhur kësaj VKM-je përcakton *“Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar Institucioni”,ne institucionet qendrore të përcaktuara sipas pikes 1/2.*

Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin e punës:

Në këtë VKM përcakton qartë pagën për çdo kategori si dhe arsimin që duhet të ketë çdo punonjës i administratës publike për tu punësuar në një pozicion të caktuar pune, si dhe Urdhërin e Kryeministrit, nr.47, datë 12.04.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së autoritetit kombëtar për certifikimin elektronik dhe sigurinë kibernetike”, **kategoria e pagave paraqitet si më poshtë:**

- Drejtori i Përgjithshëm, kategoria II-a.
- Drejtor Drejtorie, kategoria II-b.
- Përgjegjës Sektori, kategoria III-a/1.
- Specialiste, kategoria III-b.
- Specialistë, kategoria IV-a.
- Specialiste, kategoria IV-b.

Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave, për periudhën objekt auditimi, rezultoi sa vijon:

Nivelet e pagave të punonjësve të Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike (nëpunësve) janë zbatuar konformë:

✓ VKM nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendëskryeministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës.....Institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës.....”.

Nga auditimi i kryer rezultoi se: Në Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike, nuk është paguar asnjë punonjës jashtë organike. **Punonjësit trajtohen me Statusin e Nëpunësit Civil.**

Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e kategorive të pagave të nëpunësve të Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike, në përputhje me strukturën e mësipërme të miratuar, rezultoi se: Në mbështetje dhe në zbatim të akteve të mësipërme, Autoriteti Kombëtar Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike, ka bërë miratimin e strukturës së saj, me emërtesat e punonjësve.

Pra dokumentohet hartimi dhe miratimi i strukturës, me emërtesat e punonjësve, sipas kategorizimeve dhe klasifikimit të vendeve të punës dhe kategorive përkatëse të pagave të tyre, konformë akteve në fuqi, duke bërë të mundur zbatimin e Vendimeve të mësipërme.

Nga verifikimi i kryer mbi respektimin e numrit të punonjësve rezultoi se ai sipas viteve paraqitet sa vijon:

Nr	Periudha	Numri i miratuar i punonjesve ne strukture	Fakti
1	Viti 2017	17	12
2	Viti 2018	17	12

Përfundimisht sa sipër konkludojmë që:

- Ekziston një bashkëpunim i mirëvendosur për shkëmbimin e informacionit midis Drejtorisë dhe Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- Gjurmët e auditimit, përfshijnë mbajtjen e dokumentacionit bashkëlidhur Listë Pagesave gjatë procesit të përlogaritjes së vlerës së pagës së grupit të nëpunësit.

Respektimi i dispozitave ligjore për llogaritjen dhe derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat.

REALIZIMI I FONDIT TE PAGAVE

Nr	Periudha	Plan (vjetor)	Fakt	%
1	Viti 2017	12.383.055	9.196.530	74.3
2	Viti 2018 (4-mujori)	16.900.000	4.833.780	29

REALIZIMI I SIGURIMEVE SHOQERORE E SHENDETSORE

Nr	Periudha	Plan	Fakt	%
1	Viti 2017	1.631.040	1.438.984	88
2	Viti 2018(4-mujori)	2.400.000	749.829	31

Ndaj Listë Pagesave janë bërë:

a.Ndalesat e kontributeve të detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (pjesa e të punësuarit).

b.Ndalesat e tatimit mbi të ardhurat.Respektivisht, sipas periudhave:

Sigurimet shoqërore janë llogaritur dhe mbajtur konformë:

✓ Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nenligjore.

Tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi janë llogaritur dhe mbajtur konformë:

✓ Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar,

✓ Ligjit nr 107/2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat.”, të ndryshuar.

✓ Ligjit nr 177/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

✓ Autoriteti Kombëtar i Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike, ka llogaritur dhe derdhur në kohë të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi që rrjedhin nga pagat e personelit.

Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të vecantë, dhënien e shpërblimeve të ndryshme. (për rezultate të mira në punë, ndihma për fatkeqësi, nevoja kulturore etj.).

Për periudhën objekt auditimi, nuk ka krijim dhe përdorim të fondit të vecantë, dhe dhënia shpërblimesh të ndryshme, për rezultate të mira në punë, ndihma e fatkeqësi etj.

Dokumentimi i punës dhe i pagës.

Nga auditimi i Listë Pagesave u evidentua dhe konstatua që :

✓ Listë pagesat janë të plotësuara me të gjitha të dhënat sipas VKM-së së pagave (Paga e kategorisë, paga e grupit vjetërsia për vite pune, si dhe shtesat e tjera të përfituara nga pozicioni i punës).

✓ Listë pagesat janë plotësuar nga punonjësi i caktuar për hartimin e pagave. Ato janë nënshkruar nga punonjësi i caktuar për menaxhimin e burimeve njerëzore (Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Administrimit), nëpunësi zbatues (Specialisti i Financës) dhe Titullari i Institucionit/Nëpunësi Autorizues i njësisë si përgjegjës për financat e njësisë, konformë

kërkesave të përcaktuara në pikën 69, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

✓ Përmbledhja e listë pagesave që shoqëron Urdhërin për Shpenzimin e pagave është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës) dhe Nëpunësi Autorizues (Titullari i Institucionit)

✓ Të gjitha detyrimet e Autoritetit Kontraktor të Certifikimit Elektronike dhe Sigurisë Kibernetike, për pagesën e pagave të punonjësve janë paguar vetëm nga llogaria e thesarit, nëpërmjet sistemit të thesarit nga personat e autorizuar.

✓ Autoriteti Kontraktor i Certifikimit Elektronike dhe Sigurisë Kibernetike, ka llogaritur dhe derdhur në kohë të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi që rrjedhin nga pagat e personelit.

Përfundimisht sa sipër, nga auditimi i sistemit të pagave dhe pagesave të kryera pranë organeve Tatimore, për derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat, auditimi vlerëson dhe konkludon se;

➤ ***Kontrolli i brendshëm në këtë sistem ka funksionuar i plotë nga të gjitha hallkat brenda Institucionit.***

➤ ***Ekzistenca dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm ka sjellë për pasojë; -që risku në këtë sistem të vlerësohet, monitorohet dhe minimizohet (vetëkorrigjimet e kryera nga Sektori i Financës, lidhur me përcaktimin dhe përlllogaritjen e pagës së grupit.)***

- parandalimin dhe zbulimin e gabimeve, parregullsive, shkeljeve ligjore dhe përcaktimin e masave për korrigjimin e tyre;

➤ ***Menaxhimi ka marrë masa për identifikimin dhe reduktimin e riskut, me masat e duhura të kontrollit, Risku paraqitet në Nivel të ulët.***

III. Auditimi Financiar

1) Zbatimi i rregullave në hartimin, miratimin e planit të buxhetit për vitin 2017 dhe 2018.

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike AKCESK në hartimin dhe miratimin e buxhetit për periudhën e audituar vitet 2017 dhe 2018, ka zbatuar kërkesat ligjore në fuqi të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit”.

Konkretisht për vitin 2017, sipas kërkesave të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dekretuar me dekretin e presidentit Nr. 9905, datë 23.12.2016, si dhe konform shkresës së Ministrisë së Financave nr. 6964/2 datë 24.05.2017, me të cilën është dërguar miratimi i detajimit të buxhetit për vitin 2017, shkresës nr. 7117/1 datë 25.05.2017 me të cilën është dërguar miratimi i kalimit të numrit të punonjësve si dhe shkresën nr. 9443/1, datë 07.08.2017 është dërguar këtij autoriteti edhe miratimi i detajimit të investimeve për vitin 2017.

Për vitin 2017, në mbështetje të kërkesave të ligjislacionit të mësipërm me shkresën nr. 9443/1, datë 07.08.2017, i është dërguar agjensisë detajimi i shpenzimeve kapitale të këtij viti nga

Ministria Financave. Nga kjo ministri me shkresën nr. 6964/2 datë 24.05.2017, i është dërguar edhe detajimi i limitit mujor të shpenzimeve si dhe me shkresën nr. 7117/1 datë 25.05.2017 është bërë miratimi numrit të punonjësve për këtë vit.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nga autoriteti janë zbatuar aftet kohore të hartimit të projekt buxhetit dhe paraqitjes së tij për miratim për këtë periudhë..

Për këto raste të ndryshimit të fondeve, janë zbatuar dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

U konstatua se detajimi i fondeve janë bërë në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" për të cilat nuk u konstatuan parregullsi. Të gjitha procedurat e transferimeve ndërmjet kategorive buxhetore dhe autorizimi i kryerjes së transfertave në sistem janë konfirmuar nga Drejtori i Përgjithshëm konform rregullave.

Nga auditimi mbi respektimin e limiteve brenda zërave të planifikuar dhe rakordimi me degën e Thesarit rezultoi se:

Janë zbatuar limitet për fondet buxhetore të miratuara sipas zërave të shpenzimeve.

Sektori i Financës ka mbajtur akt rakordimin për shpenzimet. Bazuar në situacionin e shpenzimeve i cili është i rakorduar me Degën e Thesarit. Nga auditimi nuk rezultuan mangësi në këtë drejtim. Ndryshimet janë pasqyruar saktë sipas titullit dhe artikullit përkatës të akorduar. Nga agjensia është bërë rakordimi me degën e thesarit të shpenzimeve mujore dhe rekordimi progresiv vjetor sipas zërave të buxhetit si dhe sipas programeve të miratuara në planin e buxhetit për çdo vit. Nuk konstatohet ndryshim të destinacionit të përdorimit të fondeve të akorduara.

Konkretisht plani përfundimtar dhe realizimi faktik i buxhetit të agjensisë për vitin 2017 dhe 2018 paraqitet në tabelen e mëposhtme.

Artikulli	Plani bashk me rialokimet 2017	Realizimi faktik	Real. në %	Plani bashk me rialokimet 2018	Realizimi faktik 4-mujori 2018	Real.në %
600	12,383,055	6,814,221	55	16,900,000	4,833,780	29
601	1,631,040	1,041,736	64	2,400,000	749,829	31
602	12,241,482	1,783,176	15	13,500,000	777,152	6
231	64,180,000	750,000	1	18,000,000		0
Shuma.		10,389,133	11	50,800,000	6,360,761	13

	90,435,577				
--	------------	--	--	--	--

Siç relatohet në të dhënat e mësipërme rezulton se realizimi i fondeve për vitin 2017 është në masën 11 % në total dhe 1% për sa i përket investimeve. Planifikimi dhe miratimi i fondeve për investime është bërë me rezevë pasi autoriteti është ngritur si institucion i ri në prill të vitit 2017.

Nga auditimi rezulton se për vitin 2018 janë planifikuar 18 milion lekë për investime nga 64 milion që ishin planifikuar për vitin parardhës. Mosrealizimi i fondeve për investime ka ndikuar në mosrealizimin e objektivave të këtij autoritetit. Theksojmë se ndikim në këtë drejtim ka patur edhe mosplotësimi i organikës me personelin e kërkuar si dhe procesi i ngritjes dhe konsolidimit të autoritetit si institucion i ngritur rishtazi.

Për 4 mujorin e parë të vitit 2018, realizimi i fondeve në total rezulton në masën 13% dhe fondet për investime paraqiten në masën 0%. Ky tregues tregon se edhe për këtë vit agjensia nuk e ka realizuar në masën e kërkuar objektivin e saj.

Në mënyrë të detajuar sipas zërave të miratuara realizimi i tyre sipas viteve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

VITI 2017				4MUJORI 2018			
Pershkrimi	Plan	Fakt	%	Pershkrimi	Plan	Fakt 4/M	%
Kancelari	544,066	-	0				
Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës	226,694	-	0	Kancelari	400,000	186,840	47
Blerje dokumentacioni	45,339	-	0	Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	800,000	153,864	19
Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjishme	181,355	-	0	Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës	400,000	-	0
Libra dhe publikime profesionale	226,694	-	0	Blerje dokumentacioni	99,000	-	0
Sherbime telefonike	90,678	27,524	30	Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjishme	99,000	-	0
Posta dhe shërbimi korrier	18,136	11,430	63	Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik	99,000	-	0
Sherbime të printimit dhe publikimit	362,711	155,520	43	Sherbime telefonike	150,000	27,172	18
Kosto e trajnimit dhe	453,388	-	0	Posta dhe shërbimi korrier	50,000	17,900	36

seminareve							
Sherbime te tjera	2,085,586	251,504	12	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	500,000	36,017	7
Shpenzime te tjera transporti	90,678	-	0	Sherbime te printimit dhe publikimit	800,000	42,000	5
Udhetim i brendshem	1,224,148	-	0	Kosto e trajnimit dhe seminareve	800,000	-	0
Udhetim jashte shtetit	3,763,122	1,087,630	29	Sherbime te tjera	99,000	-	0
Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore	453,388	-	0	Shpenzime te tjera transporti	99,000	-	0
Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	544,066	-	0	Udhetim i brendshem	800,000	-	0
Shpenzime per qiramarrje ambjentesh	634,744	-	0	Udhetim jashte shtetit	2,700,000	233,731	9
Shpenzime per pritje e percjellje	634,744	249,568	39	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore	800,000	-	0
Shpenzime per aktivite sociale per personelin	90,678	-	0	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	1,299,000	7,800	1
Shpenzime per honorare	90,678	-	0	Shpenzime per qiramarrje ambjentesh	306,000	56,828	19
Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca	181,355	-	0	Shpenzime per pritje e percjellje	700,000	-	0
Shpenzime per tatime dhe taksa te paguara nga institucioni	90,678	-	0	Shpenzime per honorare, perkthimi	800,000	-	0
Shpenzime te paparashikuara	208,559	-	0	Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca	500,000	-	0
				Shpenzime per tatime dhe taksa te paguara nga institucioni	400,000	15,000	4
				Shpenzime te paparashikuara	800,000	-	0

Sic rezulton nga të dhënat e mësipërme për vitin 2017 realizimi i shpenzimeve sipas nuk është i mirë, ndërsa për vitin 2018 realizimi i programeve është në vazhdimësi për tu realizuar.

Grupi i auditit konstaton se dhe struktura e autoritetit si institucion i krijuar rishtazi në mars të vitit 2017, nuk është e plotësuar me personelin e miratuar në strukturën e saj. Faktor ky që ka ndikimin e vet në realizimin e investimeve të programuara.

Rekomandim:6. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike të marrë masat e nevojshme për realizimin e fondeve të akorduara. (Rëndësia i/e mesme)

2) Zbatimi i rregullave në kryerjen e shpenzimeve, respektimi i limiteve të shpenzimeve.

Për të verifikuar rregullshmërinë e shpenzimeve të kryera nga Autoriteti u auditua dokumentacioni i pagesave të kryera me bankë dhe arkë në lekë dhe në valutë, për pagat, blerjet me vlera të vogla, shpenzimeve të kncelarie, investime etj, për gjithë periudhën objekt auditimi. Rezulton se nuk ka veprime të kryera me arkën në lekë në dorë pasi të gjitha pagesat janë kaluar nëpërmjet bankës.

Nga auditimi i listëpagesave rezultoi se për periudhën e audituar, është respektuar numri i punonjësëve në përputhje me organiken e miratua. Nga auditimi i listëpagesave të punonjësve rezultoi se ato janë të plota për çdo muaj. Nga Sektori i Financës është hartuar listëpagesa me përlllogaritjet sipas listëprezencave me të gjitha shtesat dhe ndalesat për periudhën përkatëse. Nga verifikimet e bëra për muajt Mars, Qershor, Gusht 2017, Prill, Korrik, Shtator, Nëntor, Dhjetor, 2017, rezultoi se përlllogaritja e nivelit të pagave sipas strukturës dhe pozicionit të punës është në përputhje me strukturën e miratuar dhe kategorinë e pagës respektive. Përdorimi i fondeve për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore është bërë duke respektuar buxhetin e miratuar si dhe normat e sigurimeve dhe të TAP.

Për çdo muaj në zbatim të Ligjit nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 16.04.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar, është bërë llogaritja e kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, dhe derdhja e tyre në favor të tatimeve.

Në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, janë bërë ndalesat për tatim mbi të ardhurat nga punësimi dhe është bërë derdhja në favor të tatimeve. Për gjithë periudhën, derdhja e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi është bërë brenda afatit të përcaktuar në ligjet e sipërcituara.

Nga dega e financës është plotësuar rregullisht regjistri i punonjësve dhe në të janë azhurnuar të gjitha lëvizjet sipas dokumentacionit që vërteton këto lëvizje.

Nga auditimi u verifikuan pushimet vjetore të kryera dhe u konstatua se nuk ka mospërputhje mes emrave të punonjësve dhe ditëve të lejeve që do kryhen për muajin përkatës të përcaktuar në urdhërat e drejtorit të përgjithshëm dhe emrave apo ditëve të përfshira në listëpagesat e muajit përkatës. U audituan reakordimet e urdhërkalimeve të pagave në llogaritë bankare me përmbledhëset dhe listëpagesat nga ku rezultoi se nuk ka diferenca. Gjithashtu edhe kontabilizimi i veprimeve të pagave është kryer në rregull. Në listë pagesat e çdo muaji janë bërë ndalesat e shpenzimeve të telefonave celulare mbi limitin e miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit

Nga ana jonë u verifikua i gjithë dokumentacioni i shpenzimit të karburantit dhe rezultoi se shpenzimi i tij është i dokumentuar dhe justifikuar sipas fletë udhëtimeve të plotësuara për çdo udhëtim të automjetit. Nuk u konstatuan mangësi në këtë drejtim.

Përdorimi i shpenzimeve operative për periudhën e audituar rezultoi të jetë bërë sipas zërave të miratuar në buxhetin e kësaj drejtorie. Nga auditimi për pagesat e kryera për blerje dhe shërbime të ndryshme nga artikulli “602” si shpenzimet për energji, materiale pastrimi, karburant, pritje e përcjellje qera janë bërë etj, janë bërë me dokumentacion i cili vërteton shpenzimin e kryer. Nga auditimi rezultoi se nuk kemi ndryshim të destinacionit të përdorimit të fondeve si dhe nuk ka tejkalime të përdorimit të tyre. Ato janë përdorur sipas destinacionit për të cilën janë parashikuar.

3).Zbatimi i rregullave në mbajtjen e kontabilitetit, inventarizimin, përgatitjen dhe miratimin e pasqyrave financiare.

Nga Sektori i Financës mbajtja e kontabilitetit për periudhën objekt auditimi, është bërë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9477, datë 9.2.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore e lokale, si dhe të njësisve që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa ndryshime në VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore e lokale, si dhe të njësisve që varen prej tyre” dhe Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.16, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor”.

Nga auditimi i bilanceve kontabël u konstatua se:

Veprimet kontabile janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ku çdo regjistrim është bërë në bazë të dokumentave justifikuese, si dhe janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Sipas pasqyrave financiare gjëndja e aktiveve të autoritetit në fund të vitit 2017 paraqitet si më poshtë:

Grupet	Emërtimi	Viti 2017
A	Aktive të Qëndrueshme	24,223,475
B	Aktive Qarkulluese	2,134,322
C	Llogari të tjera Aktive	-
	Totali	26,357,797

Sipas pasqyrave financiare vjetore për vitin 2017, në aktivin e bilancit rezultoi se, më datë 31.12.2017, “Aktivet e qëndrueshme” zënë 91.8% të totalit të aktivitetit, ndërsa “Aktivet qarkulluese” zënë 7.2% të totalit të aktivitetit.

Ndërsa aktivet e qëndrueshme sipas zërave të llogarive perbëhen:

		Në lekë
A	Aktive të Qëndrueshme	Viti 2017
	Të patrupëzuara gjithësej	-
203	Konçensione, patentat, licensa të tjera të ngjashme	-
	Të trupëzuara	36,851,913
212	Ndërtime e konstruksione	10,202,595
214	Instalime tekn. Makin e paisje, vegla pune	21,173,822
215	Mjete transporti	-
218	Inventar ekonomik	5,475,496
219	Amortizimi i Aktiveve të qëndrueshme	-12,628,438
	Shuma	24,223,475

Aktivët qarkulluesë në fund të vitit 2017, rezultojnë me gjendje 2,134,322 lekë dhe sipas zërave paraqiten si më poshtë:

		Në lekë
B	Aktive Qarkulluese	Viti 2017
Kl 3	Gjendje inventari	304,894
31	Materiale	304,894
32	Objekte inventari	
Kl 4	Kërkesa Arkëtimi nga debitorët	1,829,428
4342	Të tjera operacione me shtetin (debitor)	1,829,428
45	Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jasht sistemit	
	Shuma	2,134,322

Sistemi i kontabilitetit nuk mbahet me programit kompjuterik të gjithë veprimet regjistrohen në ditarët përkatës. Nga verifikimi i llogarive të bilancit rezulton se për vitet 2017, dhe 2018, “Aktivi” është i barabartë me “Pasivin”. Llogaritë “sintetike” kuadrojnë me llogaritë “analitike”. Llogaritë e inventarëve për aktivet qarkulluese kuadrojnë me gjendjet e tyre në fund të çdo viti

financiar. Bilanci kontabël dhe pasqyrat financiare vjetore të institucionit janë dërguar në Degën e Thesarit me shkresën nr.60, datë 26.02.2018, për bilancin e vitit 2017.

Përgatitja e pasqyrave financiare është në pajtueshmëri me standartet e kërkuara dhe të dërguara brenda afatit ligjor.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9154, datë 06.03.2003, "Për arkivat" dhe "Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", dokumentacioni i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve për vitin 2017, ishte i depozituar në arkivin e këtijë Autoriteti.

Referuar udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik", kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve", pika 74, përcaktohet se: "Çdo njësi ekonomike duhet të kontrollojë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të elementeve dhe dokumentacionit mbështetës", si dhe në respektim të Ligjit nr.10296, dt. 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", u krye auditimi i plotë mbi inventarët dhe nxjerrjet jashtë përdorimit për periudhën e audituar. Komisioni i Inventarizimit të Aktiveve, është ngritur konformë pikës 81 e 82 "Përgjegjësitë për Inventarizimin", të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Inventarizimi i aktiveve është kryer konform rregullave të përcaktuara në Udhëzimit të sipërpërmendur të Ministrisë Financiare. Në përputhje me aktet ligjore janë kryer inventarizimet në fund të çdo viti sipas urdhërave të nxjerra nga drejtori i agjensisë për ngritjen e komisioneve të inventarizimit. Nga auditimi rezultoi se nuk kanë rezultuar diferenca krahasuar me gjendjen kontabile në këto inventarizime. Janë nxjerrë jashtë përdorimit mallra e materiale për këtë periudhë për këto nxjerrje jashtë përdorimit janë zbatuar dispozitat ligjore në fuqi. Nuk u konstatuan mangësi në këtë drejtim.

Nga auditimi konstatohet se ndiqej në mënyrë konologjike evidenca e lëvizjes së aseteve. Çdo lëvizje pasqyrohet në evidencën kontabile konform dokumentacionit të kërkuar ligjor. Gjendja e këtyre aseteve në fund të periudhës për çdo vit pasqyrohet e saktë në pasqyrat financiare të kësaj Agjencie.

Grupi i auditimit, falenderon me këtë rast, subjektin e audituar për bashkëpunimin e treguar në realizimin e këtij auditimi.

Raporti Paraprak hartohet në dy kopje, një prej të cilave i paraqitet subjektit të audituar.

Bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm brenda 10 ditë pune, subjekti i audituar duhet të kthejë një kopje të nënshkruar ose me vërejtje. Gjithashtu brenda afatit të mësipërm, subjekti ka të drejtën të kërkojë një takim pajtues për të diskutuar me grupin e auditimit për të gjitha çështjet për të cilat nuk bie dakord.

Drejtori i Përgjithshëm

Vilma TOMÇO

Për grupin e auditimit

Latif ÇELA

Flori ALLA

PLAN VEPRIMI
PËR REKOMANDIMET E LËNA NË RAPORTIN PARAPRAK TË AUDITIMIT

**Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe
Sigurinë Kibernetike.**

Nr.	Rekomanimi	Renditja sipas nivelit.	Referenca e parag. në raport	Reagimi i menaxhimit	Afati i përcaktuar
1	Autoriteti Kombëtar i Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike të miratohet rregulloren e brendshme dhe të përshtasë atë në përputhje me kërkesat e ligjit "Për nëpunësin civil" dhe strukturën organizative të miratuar.	Rendësia e mesëm.	Faqe 4		Gjat vitit 2018
2	Drejtori Përgjithshëm të kërkojë plotësimin e vendeve vakant për të garantuar realizimin e objektivave të përcaktuara nga autoriteti.	Rendësia e mesëm	Faqe 4		Gjat vitit 2018
3	Autoriteti Kombëtar i Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike të evidentojë risqet dhe të hartojë regjistrin e saj të riskut.	Rendësia e mesëm.	Faqe 5		Gjat vitit 2018
4	Të krijohet një sistem i dedikuar për verifikimin e vlefshmërisë së produkteve të gjeneruara nga shërbimet e besuara të huaja, të njohura nëpërmjet ndryshimeve ligjore duke mundësuar aksesin publik për kontrollin e vlefshmërisë së tyre nëpërmjet listave të besuara të vendeve anëtare të BE-së dhe protokollin on-line të statusit të çertifikatave dhe listave të revokimit të çertifikatave.	Rëndësia e lartë.	Faqe 7		Gjat vitit 2018

5	Të kryehet kontrolli dhe implementi i të gjitha standardeve teknike të zbatuara nga institucionet e shoqërisë së informacionit, apo infrastruktura e informacionit edhe në sektorin privat që janë ende të parrealizuara, për shkak të procesit ende të papërfunduar të hartimit të metodologjisë për funksionimin e CSIRT-ve.	Rëndësia e lartë.	Faqe 8	Gjat vitit 2018
6	Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike të marrë masat e nevojshme për realizimin e fondeve të akorduara.	Rëndësia e lartë	Faqe 18	Gjat vitit 2018

Për Autoritetin Kombëtar të Çertifikimit Elektronik e Për Drejtorin e Auditimit të Brendshëm

Sigurinë Kibernetike

Vilma TOMÇO

Drejtor i Përgjithshëm

Latif ÇELA

Flori ALLA